

VENDIM
Nr.249, datë 27.4.2007

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
PUNËVE TË JASHTME, PËR FINANCIMIN E VEPRIMTARISË “VERNISSAGE” QË DO
TË ZHVILLOHET NË VENECIA, ITALI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t’i shtohet fondi prej 40 000 (dyzet mijë) eurosh (ekuivalenti në lekë sipas kursit të ditës), për financimin e veprimtarisë “VERNISSAGE” (Bienalja e pikturës), që do të zhvillohet në Venecia, Itali.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha